




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Junikut
Opština Junik
Municipal Junik

Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport (DAKRS)
Nr. 7/15
Datë: 01.07.2026

Duke u bazuar në Ligjin Nr.08/L-153 Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, Udhëzimit Administrativ Nr.03/2022 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë, DAKRS shpall këtë:

K O N K U R S
PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE
PUBLIKE NË KOMUNËN E JUNIKUT PËR VITIN
2026/27

DAKRS shpall konkurs për këto vende të lira në institucioni parashkollore “Yjet e Gjeravicës” në Komunën e Junikut

Vendet e lira në Institucionet parashkollore 2026-2027

Grup-mosha	Vende te lira
09 -> 2 vjet.	9
2-> 3 vjet.	11
3-> 4 vjet.	15
4-> 5 vjet.	7
Gjithsej	42

I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

- Dokumenti personal i prindit (letërnjoftim ose pasaportë);
- Ekstraktin e lindjes së fëmijës;
- Certifikata e vendbanimit;
- Njëra prej faturave të shërbimeve komunale, jo më të vjetra se gjashtë muaj;(Rrymës, Ujë apo Mbeturinave)
- Dëshmia për vaksinimin e fëmijës (fletorja e shëndetit të fëmijës);
- Kontrata për marrëdhënien e punës për të dy prindërit (nëse prindërit janë në marrëdhënien e punës;
- Pasqyra e Trustit për gjashtë (6) mujorin e fundit;

II. Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të fëmijëve në institucionet parashkollore

Regjistrimi i fëmijëve në IP do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parashkollor (Ligjit Nr.08/L-153 Edukimin në Fëmijërinë e Hershme), në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 03/2022 për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë dhe në Vendimin e kriterëve të pranimin të fëmijëve në institucionet parashkollore publike nga DAKRS.

III. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur nga data **01.07.2026** e deri më datën **15.07.2026**;
- Dokumentacioni i plotësuar dorzohet ne Instuticionin parashkollore “Yjet e Gjeravices” çdo ditë pune prej orës 08:00 deri në ora 16:00;

Vërejtje: Të gjitha dokumentacionet e pakompletuara dhe jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

